



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 280/004

Dt 03.03.2017

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2017, mori:

VENDIM

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Mirsad Suhodollit me nr. prot. 1603 të datës 15.12.2016, për mosinformim, në bazë të konkursit të shpallur më 31.10.2016 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një ligjëruesi të gjuhës angleze, në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Ankimuesi Mirsad Suhodolli ka paraqitur ankesë me nr. prot. 1603 të datës 15.12.2016, me të cilin pretendon se i është bërë shkelje për arsye të mosinformimit dhe për arsye të angazhimit të Edita Fejzës në procesin e mësimdhënies.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2017, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtrësia, konstatoi se Universiteti i Mitrovicës e ka shpallur në ueb-faqen zyrtare njoftimin për këtë pozitë, më 20.01.2017, në bazë të të cilit "Askush nuk i ka plotësuar kriteret për pozitën "Një ligjërues për gjuhë angleze". Ndërsa, angazhimi i Edita Fejzës në procesin e mësimdhënies është bërë në bazë të vendimit të Senatit nr. prot. 1310, të datës 01.11.2016, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it